



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12 Korrik 2023

Nr: 691

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMEVE NR. 417, 421, 429 DHE 431 ID PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Data: 12 Korrik 2023

Nr: 691
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 417, 421, 429 dhe 431 ID.”

-Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.

-Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 11.5.2023, është administruar shkresa nëpërmjet postës elektronike nga z. Edmond Spaho, i regjistruar me nr. 417 ID, me lëndë *“Veprimtari e ndaluar”*, me objekt denoncimi *“Zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka zhvilluar në datë 28.04.2023 aktivitete publike të ndaluara me vendim e sipërcituar. Konkretisht, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e sipërcituar nr.413, datë 25.04.2023, ndalon zhvillimin e aktiviteteve publike të bashkisë Maliq, si më poshtë: Takim pune nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 14:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit “Njësia Administrative Pojan”. Takim pune nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 16:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit “Njësia Administrative Pojan”. Inspektim punimesh nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 11:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit “Njësia Administrative Pojan”. Inspektim punimesh nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit “Njësia Administrative Pojan”. Në kundërshtim me këtë vendim të KSHZ, kryetari i Bashkisë Maliq i ka zhvilluar këto takime dhe ka postuar në faqen personale në rrjetin social Facebook, foto të zhvillimit të këtyre aktiviteteve të ndaluar si më poshtë: (Foto e postimit ne facebook).”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi i regjistruar me nr. 421 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Më datë 07 Maj 2023, faja zyrtare e Spitalit Rajonal Berat, ka postuar në rrjetin social Facebook, një poster të fushatës së kandidatit dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë. Në poster vihen re elementet e përdoruara nga ana e Partisë Socialiste përgjatë fushatës zgjedhore si dhe slogani “Vetëm përpara, kurrë më mbrapa” dhe deklarimi se Berati mirëpret Edi Ramën. Postimet janë të datës 07.04.2023, nëpërmjet së cilit postohet foto e Edi Ramës dhe kandidatit për kryetar bashkie të subjektit zgjedhor partia Socialiste e Shqipërisë, ku shkruhet 08 Maj 2023, ora 17:00, Berati mirëpret Edi Ramën.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi i regjistruar me nr. 429 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në data të ndryshme, në faqen zyrtare të Njesisë Administrative nr. 7, janë postuar në rrjetin social Facebook, postime me përmbajtje qartësisht elektorale të kandidatit z. Veliq dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë. Në këto postime vihet re përdorimi i sloganeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, thirrje për mbështetjen e Erion Veliqit, si dhe shpërndarje të aktivitetit politik të këtij të fundit. Postimet janë të datave 27.04.2023, 15.04.2023, 21.04.2023, 25.04.2023, ripostim të aktiviteteve të postuar në faqen e z. Veliq si dhe zj. Etilda Gjonaj ndër të tjera janë përdorur hashtag.”*

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar denoncimi i regjistruar me nr. 431 ID, me lëndë *“Përdorim i burimeve publike”*, me objekt denoncimi *“Në data të ndryshme,*

në faqen zyrtare të Njesisë Administrative nr. 8, janë postuar në rrjetin social Facebook, postime me përmbajtje qartësisht elektorale të kandidatit z. Veliq dhe subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë. Në këto postime vihet re përdorimi i slloganeve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, thirrje për mbështetjen e Erion Veliqit, si dhe shpërndarje të aktivitetit politik të këtij të fundit". Postimet janë të datave 25.03.2023, 07.04.2023, 16.04.2023, ripostim të aktiviteteve të postuar në faqen e z. Veliq, ku ndër të tjera janë përdorur hashtag."

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "dh", "f", dhe "n" e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre" të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimeve nr. 417, 421, 429 dhe 431 ID.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI